



РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT



Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 të Ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" Nr. 12/2019) nenit 40 paragrafi 3 të Rregullores së punës së Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit, (në tekstin e mëtejshëm: KSHPK) duke vepruar në bazë të lëndës së formuar me vet iniciativë, në seancën e 76-të, të mbajtur më datë 20.10.2022 morri,

VENDIM

Procedura e KSHPK-së në lëndën me numër 08-4160/1 të datës 04.09.2019, e formuar me vetiniciativë, për verifikimin e të dhënave nga lista anketuese i ///. ///, NDËRPRITET.

KSHPK -ja nuk ka elemente për veprime të mëtejshme në rastin konkret.

Vendimi në formë të depersonalizuar, të publikohet në ueb - faqen e KSHPK-së brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e vendimmarrjes.

Arsyetim

Lënda me numër 08-4160/1 të datës 04.09.2019 është formuar në bazë të Planit Vjetor për monitorimin e situatës së pronës dhe interesave për vitin 2019.

personi /// ka dorëzuar flet anketuese pas emërimit në funksionin /// më 30.06.2017.

Me kërkesë të KSHPK-së nga ana e të emëruarit janë dorëzuar të dhëna anëtarët tjerë të familjes me të cilët jetojnë në një familje të përbashkëtë:

bashkëshortja ///

- i biri- ///;

KSHPK, me qëllim përcaktimin e gjendjes faktike në rastin konkret, për pronën e----- dhe anëtarëve të familjes së tij morri të dhëna nga Agjencia për Kadastër të patundshmërisë, Ministria e Punëve të Brendshme, drejtoria e të Hyrave Publike, Depozituesi Qendror i Letrave me Vlerë dhe Regjistri Qendror i Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Pas shqyrtimit të grumbullimit të të dhënave, KSHPK-ja vërtetoi si më poshtë:

- Nga Deklarata Vjetore Tatimore për vitin 2019, KSHPK-ja ka konstatuar se ----- në vitin 2019 ka realizuar të hyra kapitale në vlerë bruto prej ----- denarë dhe fitime kapitale në vlerë bruto ----- denarë.

Në fletën anketuese t; dorëzuar në KSHPK më 17.01.2020, pas përfundimit të pozitës së ----- së Republikës së Maqedonisë së Veriut, në rubrikën "TË ARDHURA TJERA", -----nuk ka raportuar se realizon të ardhura nga bazë e deklaruar.

Nga sa më sipër, KSHPK-ja konstaton se -----ka kryer shkelje të nenit 82 paragrafi 3 c.v. me nenin 82 paragrafi 1 dhe nenin 82 paragrafi 2 paragrafi 1 të Ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesit, të dënueshme sipas nenit 109 të të njëjtit ligj.

KSHPK-ja ka kryer procedurën e zgjidhjes duke lëshuar një urdhër shkelje me numër 08-1441/4 të 06.12.2021.

Personi i emëruar nuk ka vepruar me urdhërpagesë për kundërvajtje në afatin e përcaktuar me ligj, për çka KSHPK-ja ka paraqitur kërkesë në Komisionin për Kundërvajtje në KSHPK për ngritjen e procedurës për kundërvajtje ndaj personit të caktuar.

Duke pasur parasysh të theksuarën e mësipërme, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit vendosi si në dispozitën e këtij vendimi.

Përgatiti:

Miratoi:

KOMISIONI SHTETËRORE
PËR PARANDALIMIN E KORRUPTIONIT
Kryetare,
Biljana Ivanovska

